



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1900/8 prot.

Datë 13.08.2026

V E N D I M
Nr. 972/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtare
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.08.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP”, me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar më datë 07.01.2026, nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik, “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me NIPT K21710002J dhe me adresë: Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8, Tiranë, Shqipëri. , Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

“Albanian Gas Services Company” Sh.A. me adresë
Rruga e Kosovareve, Pallati Ndërpro shpk, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë
19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të
Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për
miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin
e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me
shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e
ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje
me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat
e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye
legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe
njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në
ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë
autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.01.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e
prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një
operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-73633-01-06-2026,
me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit)
përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (*gjashtëmbëdhjetë milion
e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër*) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind
e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit

i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

II.2. Në datën 16.02.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 02.03.2026, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk	12,362,310.00 lekë	skualifikuar
2. “ALTEC” SHPK	15,170,000.00 lekë	skualifikuar

II.4. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se me 03.03.2026, është publikuar “Njoftim Anulimi” i procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 18, datë 09.03.2026.

II.5. Me datë 10.03.2026, është depozituar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, ku është administruar me nr. 764/2026 protokoli, datë 11.03.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6405 e OE “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, për procedurën e prokurimit sipër cituar, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

II.6. Në datë 27.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.435/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të kualifikojë operatorin ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK.

5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 31.03.2026, është bërë **Ri-klasifikimi** i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- | | | |
|---|-------------------|--------------------|
| 1. “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk | 12,362,310.00lekë | Kualifikuar |
| 2. “ALTEC” SHPK | 15,170,000.00lekë | Skualifikuar |

II.8. Në datë 03.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.470/2026, ku vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.9. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se me 16.04.2026, është publikuar “Njoftim i Fituesit paraprak” i procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 28, datë 20.04.2026.

II.10. Me datë 06.05.2026, referuar informacionit të dhënë nga ankimuesi, rezulton se, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, Formularin e Sigurimit të Kontratës” dhe “Policën e Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale”, në zbatim të “Njoftim i Fituesit në përfundimtar të afateve të ankimit” në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike 30, datë 04.05.2026, drejtuar operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk.

II.11. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se me 04.06.2026, është publikuar “Njoftim Anulimi” i procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 37, datë 08.06.2026.

II.12. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 04.06.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit në SPE, sipas njoftimit të publikuar në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.37, datë 08.06.2026, ku janë dhënë arsyet si më poshtë: “[...] 6. Arsyet e Anulimit: Bazuar në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” neni 98, pika 1:

-në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;

-në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme; konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

X për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;

-kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;

-kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.

7. Informacion shtesë: Albanian Gas Service Company SHA (AGS SHA) ka zhvilluar procedurën e hapur mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje kuadër me REF-73633-01-06-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” dhe me fond limit prej 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Në përfundim të kësaj procedure, operatori ekonomik fitues rezultoi “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k., me NUIS K21710002J, i cili është njoftuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik në datën 28.04.2026, me të cilin nuk është lidhur ende marrëveshja kuadër për arsyet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor, AGS sh.a., është një shoqëri aksionare italo-shqiptare (SNAM S.p.A. 25% dhe Albgaz sh.a. 75%), e cila ka si mision mirëmbajtjen e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (TAP) dhe impianteve të lidhura me të në territorin e Republikës së Shqipërisë. E drejta e mirëmbajtjes nga një entitet publik shqiptar është përcaktuar në marrëveshjen për kalimin e gazsjellësit në Shqipëri, ndërsa AGS sh.a. është themeluar në bazë të VKM nr. 609, datë 17.10.2018 “Për miratimin e marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët ndërmjet SNAM S.p.A. dhe Albgaz sh.a., lidhur më 11 qershor 2018”. Aktiviteti i shoqërisë materializohet në Kontratën e Mirëmbajtjes ndërmjet Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGS sh.a., datë 28.12.2018.

Në zbatim të kësaj kontrate mirëmbajtjeje, për realizimin e shërbimeve ndaj TAP, AGS sh.a. mbulon dy kategori shërbimesh:

1. Shërbime që i ofrohen TAP drejtpërdrejt nga resurset e AGS sha nëpërmjet punonjësve, mjeteve, aseteve të vet AGS sha

2. Shërbime që i ofrohen TAP nëpërmjet nënkontraktorëve, të përzgjedhur nga AGS sha përmes procedurave të prokurimit publik, për të cilët kërkohet edhe miratimi i TAP, duke qenë se ky i fundit kompenson AGS sh.a. për kostot përkatëse të nënkontraktorëve/fituesve, së bashku me një përqindje shtesë (markup) për menaxhimin e kontratave.

Referuar kësaj ndarjeje, kontrata me objekt “Mirëmbajtja e sistemit HVAC (ngrohje, ventilim dhe kondicionim ajri) në ambientet e Gazsjellësit TAP” bën pjesë në kategorinë e dytë të shërbimeve.

Për sa më sipër, AGS sh.a. ka detyrimin të marrë paraprakisht miratimin e TAP dhe, në varësi të vlerës (mbi 50,000 euro), edhe miratimin e Këshillit Mbikëqyrës, sipas Statutit të shoqërisë, përpara nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër apo kontratave me operatorët fitues.

Në këtë kuadër, në datën 30.04.2026, AGS sh.a. i ka përcjellë TAP, nëpërmjet postës elektronike, ofertën ekonomike të operatorit fitues “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k., me qëllim marrjen e miratimit. Në datën 02.06.2026, TAP na ka vënë në dijeni se nuk e aprovon operatorin ekonomik fitues, dhe duke filluar nga ky moment ky shërbim nuk do të realizohet përmes AGS sha për gjithë periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se në procedurën e zhvilluar nuk rezulton asnjë ofertë tjetër e përshtatshme.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në nenin 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit, ndër të tjera, kur për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektivë ndryshojnë nevojat ose aftësia paguese e tij, konstatohet se AGS sh.a. ndodhet në kushtet e anulimit të procedurës së prokurimit.

Në mënyrë të veçantë, refuzimi i miratimit nga ana e TAP përbën një rrethanë objektive që ndikon drejtpërdrejt në mbulimin financiar të kontratës, pasi kostot përkatëse nëse do të lidhim marrëveshjen kuadër me OE fitues nuk mund të kompensohen nga klienti TAP. Për më tepër, mungesa e ofertave të tjera të përshtatshme e bën të pamundur vijimin e procedurës. Në këto kushte, AGS sh.a. vendos anulimin e procedurës së prokurimit për objektin e sipërcituar.

Me publikimin e këtij formulari, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

II.13. Në datën 15.06.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6815, me nr. protokolli 1900/2026 datë 16.06.2026 e operatorit ekonomik, “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, ku u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, dhe rikthimin e situatës juridike, në fazën e lidhjes së kontratës.

II.14. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me nr.1900/1 prot., datë 16.06.2026, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.15. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, me shkresën përcjellëse me nr. 9/18 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1900/2 prot., datë 22.06.2026, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues me argumentin se:

Nga verifikimet e kryera kam konstatuar se, në datën 03.06.2026, Autoriteti Kontraktor ka ngarkuar në SPE formularin e njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit për procedurën e prokurimit me REF-73633-01-06-2026. Ky formular është publikuar më pas në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 37, datë 08.06.2026.

Sipas këtij njoftimi, AK është bazuar në nenin 98 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", pika 1, germa "ç", ku përcaktohet se procedura anulohet kur, për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar. AK ka përfshirë në këtë argumentim të gjithë informacionin e nevojshëm dhe arsyet objektive (mosaprovimin zyrtar nga ana e kompanisë TAP AG) që çuan në pamundësinë e vijimit të procedurës. Gjithashtu në njoftim sqarohet se ky shërbim pas anulimit të procedurës nuk do të realizohet më përmes AGS sha për gjithë periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure.

Theksohet se mosaprovimi i operatorit ekonomik ankues nga ana e TAP AG përbën një rrethanë objektive dhe të pavarur nga vullneti i Autoritetit Kontraktor. Në kushtet kur shërbimi kryhet në ambientet e TAP AG (për llogari të tij) dhe financohet e kompensohet po nga klienti TAP AG, në bazë të marrëveshjes ekzistuese, mosaprovimi i këtij të fundit sjell ndryshimin e kushteve financiare dhe të nevojës për realizimin e procedurës nga vetë Autoriteti Kontraktor. Ky mekanizëm reflekton mënyrën e funksionimit institucional të shoqërisë që nga themelimi i saj, si një kusht financiar dhe operacional i lidhur ngushtësisht me mbulimin e kostove të kontratës.

Për rrjedhojë, pretendimet e ankuesit janë të pabazuara në rrethanat e faktit dhe në kuadrin ligjor në fuqi, kur pretendon se nuk jemi në kushtet e rrethanave objektive.

Përsa i përket pretendimit të ankuesit se në njoftimin e anulimit nuk referohet asnjë provë objektive dhe se duhet t'i vihet në dispozicion korrespondenca e AK me TAP AG, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor nuk ka asnjë detyrim ligjor t'i bashkëlidhë njoftimit të anulimit apo t'i vërë në dispozicion ankuesit dokumentacion shtesë apo prova shkresore konfidenciale të marrëdhënieve me të tretët, përveç formularit të njoftimit të argumentuar. Në këto kushte, pretendimet e ankuesit për këtë pikë nuk qëndrojnë.

Për të anuluar procedurën, nëpunësi i autorizuar i AK-së ka respektuar me korrektësi përcaktimet në nenin 38 "Njoftimi i anulimit" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikës 3.12 "Procesi i Anulimit të procedurave në SPE" në Udhëzimin e APP-së nr. 1, datë 03.06.2025 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike", i cili shoqërohet nga Manuali Teknik përkatës.

Formulari i njoftimit të anulimit është plotësuar me të gjithë informacionin e kërkuar nga rregullat e prokurimit publik, përfshirë bazën ligjore dhe arsyetimin e anulimit. Në këto kushte, pretendimi i ankuesit se këto elementë mungojnë nuk qëndron.

Sqarojmë se nuk është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktor nëse operatori pretendon vonesa apo vështirësi në aksesimin e arsyetimit të plotë në sistemin SPE që nga momenti i publikimit. Për funksionimin teknik apo shfaqjen e të dhënave në platformë, ankimesi duhet t'i drejtohet për sqarim institucionit kompetent, APP që menaxhon dhe administron sistemin SPE.

Për sa më sipër, referuar pikës 3 të nenit 98 të LPP-së, autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni, ndaj pretendimet e ankimuesit për shfuqizimin e vendimit të marrë nga AK për anulimin e procedurës me objekt "Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP" vlerësohen si tërësisht të pabazuara në ligj dhe në prova.

Për rrjedhojë, vlerësohet që kjo ankese të refuzohet, duke lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktor.

Zyrtari i ngarkuar

II.16. Më shkresën me nr. 1900/3 prot., datë 23.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtuar autoritetit kontraktor "*Albanian Gas Services Company*" Sh.A., ku kërkoi informacion shkresor dhe të dokumentuar në lidhje me rrethanat apo kushtet detyruese, të ndryshimit të kushteve teknike dhe strategjike të institucionit, që çuan në mos realizimin dhe anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.17. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 9/18 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1900/4 prot., datë 24.06.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar përsëri të njëjtin informacion, ku ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik konkretisht informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar.

II.18. Me shkresën me nr. 9/20 prot., datë 13.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1900/5 prot., datë 15.07.2026, ka dërguar kthim përgjigje në zbatim të kërkesës me nr. 1900/3 prot., datë 23.06.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Advanced Business Solutions - ABS*" SHPK, mbi kundërshtimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi me Nr. REF-73633-01-06-2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 04.06.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit në SPE, sipas njoftimit të

publikuar në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.37, datë 08.06.2026, ku janë dhënë arsyet si më poshtë: “[...] 6. Arsyet e Anulimit: Bazuar në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” neni 98, pika 1:

-në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;

-në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme; konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

X për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;

-kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;

-kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.

7. Informacion shtesë: Albanian Gas Service Company SHA (AGS SHA) ka zhvilluar procedurën e hapur mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje kuadër me REF-73633-01-06-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjentëve të Gazsjellësit TAP” dhe me fond limit prej 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Në përfundim të kësaj procedure, operatori ekonomik fitues rezultoi “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k., me NUIS K21710002J, i cili është njoftuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik në datën 28.04.2026, me të cilin nuk është lidhur ende marrëveshja kuadër për arsyet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor, AGS sh.a., është një shoqëri aksionare italo-shqiptare (SNAM S.p.A. 25% dhe Albgaz sh.a. 75%), e cila ka si mision mirëmbajtjen e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (TAP) dhe impianteve të lidhura me të në territorin e Republikës së Shqipërisë. E drejta e mirëmbajtjes nga një entitet publik shqiptar është përcaktuar në marrëveshjen për kalimin e gazsjellësit në Shqipëri, ndërsa AGS sh.a. është themeluar në bazë të VKM nr. 609, datë 17.10.2018 “Për miratimin e marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët ndërmjet SNAM S.p.A. dhe Albgaz sh.a., lidhur më 11 qershor 2018”. Aktiviteti i shoqërisë materializohet në Kontratën e Mirëmbajtjes ndërmjet Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGS sh.a., datë 28.12.2018.

Në zbatim të kësaj kontrate mirëmbajtjeje, për realizimin e shërbimeve ndaj TAP, AGS sh.a. mbulon dy kategori shërbimesh:

1. Shërbime që i ofrohen TAP drejtpërdrejt nga resurset e AGS sha nëpërmjet punonjësve, mjeteve, aseteve të vet AGS sha

2. Shërbime që i ofrohen TAP nëpërmjet nënkontraktorëve, të përzgjedhur nga AGS sha përmes procedurave të prokurimit publik, për të cilët kërkohet edhe miratimi i TAP, duke qenë se ky i fundit kompenson AGS sh.a. për kostot përkatëse të nënkontraktorëve/fituesve, së bashku me një përqindje shtesë (markup) për menaxhimin e kontratave.

Referuar kësaj ndarjeje, kontrata me objekt “Mirëmbajtja e sistemit HVAC (ngrohje, ventilim dhe kondicionim ajri) në ambientet e Gazsjellësit TAP” bën pjesë në kategorinë e dytë të shërbimeve.

Për sa më sipër, AGS sh.a. ka detyrimin të marrë paraprakisht miratimin e TAP dhe, në varësi të vlerës (mbi 50,000 euro), edhe miratimin e Këshillit Mbikëqyrës, sipas Statutit të shoqërisë, përpara nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër apo kontratave me operatorët fitues.

Në këtë kuadër, në datën 30.04.2026, AGS sh.a. i ka përcjellë TAP, nëpërmjet postës elektronike, ofertën ekonomike të operatorit fitues “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k., me qëllim marrjen e miratimit. Në datën 02.06.2026, TAP na ka vënë në dijeni se nuk e aprovon operatorin ekonomik fitues, dhe duke filluar nga ky moment ky shërbim nuk do të realizohet përmes AGS sha për gjithë periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se në procedurën e zhvilluar nuk rezulton asnjë ofertë tjetër e përshtatshme.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në nenin 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit, ndër të tjera, kur për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektivë ndryshojnë nevojat ose aftësia paguese e tij, konstatohet se AGS sh.a. ndodhet në kushtet e anulimit të procedurës së prokurimit.

Në mënyrë të veçantë, refuzimi i miratimit nga ana e TAP përbën një rrethanë objektivë që ndikon drejtpërdrejt në mbulimin financiar të kontratës, pasi kostot përkatëse nëse do të lidhim marrëveshjen kuadër me OE fitues nuk mund të kompensohen nga klienti TAP. Për më tepër, mungesa e ofertave të tjera të përshtatshme e bën të pamundur vijimin e procedurës. Në këto kushte, AGS sh.a. vendos anulimin e procedurës së prokurimit për objektin e sipërcituar.

Me publikimin e këtij formulari, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

III.1.2. Në datën 15.06.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6815, me nr. protokolli 1900/2026 datë 16.06.2026 e operatorit ekonomik, “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, ku u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, dhe rikthimin e situatës juridike, në fazën e lidhjes së kontratës.

III.1.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me nr.1900/1 prot., datë 16.06.2026, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.4. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, me shkresën përcjellëse me nr. 9/18 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1900/2 prot., datë 22.06.2026, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me

trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues me argumentin se:

Nga verifikimet e kryera kam konstatuar se, në datën 03.06.2026, Autoriteti Kontraktor ka ngarkuar në SPE formularin e njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit për procedurën e prokurimit me REF-73633-01-06-2026. Ky formular është publikuar më pas në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 37, datë 08.06.2026.

Sipas këtij njoftimi, AK është bazuar në nenin 98 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", pika 1, germa "ç", ku përcaktohet se procedura anulohet kur, për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar. AK ka përfshirë në këtë argumentim të gjithë informacionin e nevojshëm dhe arsyet objektive (mosaprovimin zyrtar nga ana e kompanisë TAP AG) që çuan në pamundësinë e vijimit të procedurës. Gjithashtu në njoftim sqarohet se ky shërbim pas anulimit të procedurës nuk do të realizohet më përmes AGS sha për gjithë periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure.

Theksohet se mosaprovimi i operatorit ekonomik ankues nga ana e TAP AG përbën një rrethanë objektive dhe të pavarur nga vullneti i Autoritetit Kontraktor. Në kushtet kur shërbimi kryhet në ambientet e TAP AG (për llogari të tij) dhe financohet e kompensohet po nga klienti TAP AG, në bazë të marrëveshjes ekzistuese, mosaprovimi i këtij të fundit sjell ndryshimin e kushteve financiare dhe të nevojës për realizimin e procedurës nga vetë Autoriteti Kontraktor. Ky mekanizëm reflekton mënyrën e funksionimit institucional të shoqërisë që nga themelimi i saj, si një kusht financiar dhe operacional i lidhur ngushtësisht me mbulimin e kostove të kontratës.

Për rrjedhojë, pretendimet e ankimesit janë të pabazuara në rrethanat e faktit dhe në kuadrin ligjor në fuqi, kur pretendon se nuk jemi në kushtet e rrethanave objektive.

Përsa i përket pretendimit të ankuesit se në njoftimin e anulimit nuk referohet asnjë provë objektive dhe se duhet t'i vihet në dispozicion korrespondenca e AK me TAP AG, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor nuk ka asnjë detyrim ligjor t'i bashkëlidhë njoftimit të anulimit apo t'i vërë në dispozicion ankuesit dokumentacion shtesë apo prova shkresore konfidenciale të marrëdhënieve me të tretët, përveç formularit të njoftimit të argumentuar. Në këto kushte, pretendimet e ankuesit për këtë pikë nuk qëndrojnë.

Për të anuluar procedurën, nëpunësi i autorizuar i AK-së ka respektuar me korrektësi përcaktimet në nenin 38 "Njoftimi i anulimit" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikës 3.12 "Procesi i Anulimit të procedurave në SPE" në Udhëzimin e APP-së nr. 1, datë 03.06.2025 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike", i cili shoqërohet nga Manuali Teknik përkatës.

Formulari i njoftimit të anulimit është plotësuar me të gjithë informacionin e kërkuar nga rregullat e prokurimit publik, përfshirë bazën ligjore dhe arsyetimin e anulimit. Në këto kushte, pretendimi i ankuesit se këto elementë mungojnë nuk qëndron.

Sqarojmë se nuk është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktor nëse operatori pretendon vonesa apo vështirësi në aksesimin e arsyetimit të plotë në sistemin SPE që nga momenti i publikimit. Për funksionimin teknik apo shfaqjen e të dhënave në platformë, ankimesi duhet t'i drejtohet për sqarim institucionit kompetent, APP që menaxhon dhe administron sistemin SPE.

Për sa më sipër, referuar pikës 3 të nenit 98 të LPP-së, autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni, ndaj pretendimet e ankimuesit për shfuqizimin e vendimit të marrë nga AK për anulimin e procedurës me objekt "Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP" vlerësohen si tërësisht të pabazuara në ligj dhe në prova.

Për rrjedhojë, vlerësohet që kjo ankese të refuzohet, duke lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktor.

Zyrtari i ngarkuar

III.1.5. Më shkresën me nr. 1900/3 prot., datë 23.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtuar autoritetit kontraktor *"Albanian Gas Services Company" Sh.A.*, ku kërkoi informacion shkresor dhe të dokumentuar në lidhje me rrethanat apo kushtet detyruese, të ndryshimit të kushteve teknike dhe strategjike të institucionit, që çuan në mos realizimin dhe anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.

III.1.6. Me shkresën me nr. 9/20 prot., datë 13.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1900/5 prot., datë 15.07.2026, ka dërguar kthim përgjigje në zbatim të kërkesës me nr. 1900/3 prot., datë 23.06.2026.

III.1.7. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

Ndërkohe në nenin 3 *"Parime të përgjithshme"* të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.1.8. Në nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
- b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
- d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.

2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.

3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

III.1.9. Në nenin 38 “Njoftimi i Anulimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, autoriteti ose enti kontraktor harton njoftimin e anulimit, i cili dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe u komunikohet të gjithë kandidatëve ose ofertuesve. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e këtij njoftimi, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit, sipas parashikimeve në LPP dhe në këto rregulla.

2. Njoftimi i anulimit sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni³⁴ duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- numrin e referencës së procedurës;
- objektin e procedurës së prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- emrin, NIPT-et dhe adresat e ofertuesve;
- arsyet dhe bazën ligjore të anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 98, të LPP-së.

3. Autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.”

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

Në lidhje me procedurën e prokurimit objekt - ankimi, në datën 31.03.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar Ri-vlerësimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar, në zbatim të vendimit të KPP 435/2026 datë 27.03.2026. Në datën 15.04.2026, autoriteti kontraktor ka

njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave. Në datën 16.04.2026 është publikuar “Njoftim i Fituesit paraprak” në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 28, datë 20.04.2026, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk. Në datën 28.04.2026 është publikuar “Njoftim i Fituesit në përfundim të afateve të ankimit” në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 30, datë 04.05.2026, drejtuar operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS T” Shpk. Me datë 06.05.2026, referuar informacionit të dhënë nga ankimuesi, rezulton se, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, Formularin e Sigurimit të Kontratës” dhe “Policën e Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale”, në zbatim të “Njoftim i Fituesit në përfundimtar të afateve të ankimit” në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike 30, datë 04.05.2026, drejtuar operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 04.06.2026, është publikuar “Njoftim Anulimi” i procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 37, datë 08.06.2026, ku Autoriteti kontraktor ka cituar se anulimi është kryer në zbatim të pikës “ç” të nenit 98, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Në lidhje me situatën e krijuar, jo për shkak të veprimeve të autoritetit kontraktor, përbën një rrethane objektive dhe të pavarur nga vullneti i autoritetit kontraktor, kjo e cituar edhe në informacionin e dërguar pranë KPP me shkresën me nr. 9/20 prot., datë 13.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1900/5 prot., datë 15.07.2026, ka dërguar kthim përgjigje në zbatim të kërkesës me nr. 1900/3 prot., datë 23.06.2026, autoritetit kontraktor ka dhënë përgjigjen respektive, të cituar më lart, në lidhje me rrethanat detyruese për të cilat, është marrë edhe vendimi i anulimit të kësaj procedure ankimi. Legjislacioni i prokurimit publik, e përcakton në mënyrë të qartë që, një ofertë konsiderohet e vlefshme vetëm nëse ajo pëmbush të gjitha kërkesat për kualifikim, fakt të cilin Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të autoritetit kontraktor e ka shprehur me Ri-vlerësimin e datës 31.03.2026 ku operatori ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, rezulton me statusin “I kualifikuar”. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se, përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë, është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni gjykon, se anulimi i një procedure prokurimi është një e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktor, por me kushtin që të respektojë përcaktimet e nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se autoriteti kontraktor ka arritur të argumentojë ligjërisht, teknikisht dhe të provojë me

dokumentacion provues, bashkëlidhur informacionit të dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 9/20 prot., datë 13.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1900/5 prot., datë 15.07.2026, për të cilat ka kërkuar të ruhet konfidencialiteti, se cilat janë rrethanat detyruese për të cilat, është marrë edhe vendimi i anulimit të kësaj procedure ankimimi. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion mbështetës ligjor dhe teknik, mbi pretendimet e tij. Për më tepër, vet autoriteti kontraktor në informacionin e dërguar, ku ka argumentuar se, ky shërbim mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP, duke filluar nga ky moment (anulimi), ky shërbim nuk do të realizohet përmes autoritetit kontraktor AGS sha., për gjithë periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure. Gjithashtu, vlen të theksojmë se në procedurën e zhvilluar nuk rezulton asnjë ofertë tjetër e përshtatshme. Bazuar në sa më sipër, si dhe në nenin 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit, ndër të tjera, kur për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objekteve ndryshojnë nevojat ose aftësia paguese e tij, konstatohet se AGS sh.a. ndodhet në kushtet e anulimit të procedurës së prokurimit. Në mënyrë të veçantë, refuzimi i miratimit nga ana e TAP përbën një rrethanë objektive që ndikon drejtpërdrejt në mbulimin financiar të kontratës, pasi kostot përkatëse nëse do të lidhim marrëveshjen kuadër me OE fitues nuk mund të kompensohen nga klienti TAP. Për më tepër, mungesa e ofertave të tjera të përshtatshme e bën të pamundur vijimin e procedurës. Në këto kushte, AGS sh.a. ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit për objektin e sipërcituar. Sa më sipër, Komisioni gjykon se, anulimi i procedurës së prokurimit është bërë në përputhje me nenin 98, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, për këtë arsye autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit

TAP”, me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar më datë 07.01.2026, nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtare
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

